



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 302, Datë 23.10.2023

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS “AREA” PËR RISHIKIMIN E
VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 27, DATË 16.02.2023 “MBI ÇMIMIN E
APLIKUESHËM TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T’U PAGUHET
PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI ME HYRJEN NË FUQI TË VKM-SË
NR. 67, DATË 08.02.2023”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 33, pika 2, 67, 87, 88 dhe 181, gërma “b” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 67, datë 08.02.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 687, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të ndryshuar; neneve 15 dhe 16 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 930/30 prot., datë 16.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës AREA “Për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”,

Konstatoi se:

- Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA) me shkresën nr. 1810/176 prot., datë 24.02.2023, depozitoi në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 27, datë 16.02.2023 dhe me shkresën nr. 1810 prot., datë 07.03.2023, plotësoi kërkesën fillestare të datës 24.02.2023 duke shtuar disa argumente në mbështetje të kërkesës së paraqitur më herët.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 129, datë 07.04.2023 ndër të tjera vendosi: (1) Të pranojë shqyrtimin e kërkesës së shoqatës “AREA” për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë

08.02.2023”; dhe (2) Të pezullojë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me kërkesën e shoqatës “AREA”, për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr.27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023.

- Në vijim të procesit, para se ERE të shprehej me vendimmarrjen e sipërcituar mbi kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 27/2023, u vlerësua e nevojshme t’i kërkohej palëve të interesit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), nëpërmjet shkresës nr. 930/5 prot., datë 13.03.2023, qëndrimi i saj në lidhje me sa deklaruar nga shoqata “AREA” gjatë periudhës së diskutimeve të projekt aktit në lidhje me efektet apo afatet juridike të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023, të sipërcituar, pasi shoqata “AREA” ka depozituar në ERE të gjitha dokumentat për shkak se deklaronte se vullneti i MIE-s në lidhje me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67/2023 ka qënë hyrja në fuqi në muajin janar 2023.
- ERE me shkresën nr. 930/5 prot., datë 13.03.2023, vlerësoi të nevojshme marrjen e qëndrimit të MIE-s në lidhje me sa deklaruar nga shoqata “AREA” gjatë periudhës së diskutimeve si dhe në lidhje me efektet juridike të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023, së sipërcituar, përpara se ERE të shprehet me vendim mbi kërkesën e AREA-s.
- MIE me shkresën nr. 2750/1 prot., datë 12.04.2023, ktheu përgjigje në vlerësimin tonë jo shteruese, ku ndër të tjera është shprehur se: *qëllimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67/2023 është në harmoni me konceptin e përgjithshëm të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili parashikon që Këshilli i Ministrave harton metodologjinë e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike që i paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi. Ndryshimi i referuar (nga ERE)...është bërë në “Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë”, të ndryshuar, i cili përcakton çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi.*
- Duke marrë në konsideratë përgjigjen e MIE-s, së sipërcituar, u vlerësua i nevojshëm vijimi i komunikimit me shoqatën “AREA” dhe palët e tjera të mundshme, për shkak të kompleksitetit të çështjes si dhe me qëllim dhënien në mënyrë sa më objektive dhe transparente, por edhe shteruese të vlerësimeve tona në lidhje me kërkesën për rishikimin e vendimmarrjes së datës 16.02.2023.
- Në vijim të procedurës dhe në zbatim të nenit 29 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, 17.06.2016, me shkresën nr. 930/24, datë 19.09.2023 u zhvillua seanca dëgjimore me palët e interesit duke njoftuar të gjitha palët që mund të kenë interes për këtë çështje duke përfshirë dhe ankuesin. Shoqata “AREA” me shkresën e depozituar në ERE, me nr. 930/24 prot., datë 09.09.2023 me lëndë: *Njoftim për zhvillimin e një seance dëgjimore “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet Prodhuesve me Përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr.67, datë 08.02.2023”* kërkoi një; *mundësi e dytë për zhvillimin*

e seancës dëgjimore në pamundësi të ishte prezente. Seanca e parë dëgjimore teknike u zhvillua më datë 29.09.2023 me objekt diskutimi lidhur me kërkesën e shoqatës AREA “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”, me palë të pranishme nga ERE, FTL sh.a. dhe OSSH sh.a., në mungesë të përfaqësuesve të shoqatës AREA dhe MIE-s dhe më datë 04.10.2023 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore teknike me pjesëmarrje të ERE-s, shoqatës AREA, MIE-s, FTL sh.a. dhe OSSH sh.a. me të njëjtin objekt diskutimi si në seancën e zhvilluar më datë 29.09.2023.

- Duke marrë në konsideratë faktin se nëpërmjet komunikimeve shkresore por edhe nëpërmjet seancave dëgjimore me palët e përfshira (sipërcituar) të cilat kanë paraqitur provat e tyre, vlerësohet se kanë rënë shkaqet për pezullimin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s me vendimin nr. 129/2023, e për pasojë pika 2 e vendimmarrjes së bordit të ERE-s nr. 129, datë 07.04.2023 (2) *Të pezullojë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me kërkesën e shoqatës “AREA”, për rishikimin vendimit të bordit të ERE-s nr.27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”, duhet shfuqizuar.*
- Së fundi me shkresën nr. 1810/189 prot., datë 23.10.2023 të shoqatës “AREA”, u kërkua nga ankuesi (AREA) (i) *shtyrja e vendimmarrjes për shkak të pamundësisë të jetë prezent si dhe (ii) vënia në dispozicion të diskutimeve të seancës dëgjimore teknike datë 04.10.2023*, me qëllim garantimin e të drejtës së palës ankuese për t’u dëgjuar por edhe për sigurimin e provave të nevojshme që palët kërkojnë gjatë një procedure administrative, si dhe shqyrtimin e këtij dokumentacioni për të dalë më pas me propozimin, në lidhje me kërkesën e shoqatës “AREA”, vlerësojmë shtyrjen me 30 ditë kalendarike të afatit të vendimmarrjes finale të bordit të ERE-s, në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi

1. Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 129 datë 07.04.2023.
2. Pranimin e kërkesës së shoqatës AREA për shtyrjen e vendimmarrjes përfundimtarë të bordit të ERE-s *“Mbi kërkesën e shoqatës “AREA” për rishikimin vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”.*
3. Bordi ERE-s do të shprehet brenda 30 ditëve kalendarike mbi kërkesën e shoqatës AREA *“Për rishikimin vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e*

aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqatën “AREA” dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

